



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 2401 / Prot
2

Gramsh më, 28.07.2022

VENDIM

Nr. 54 dt. 30 /06/2022

PËR

“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasve Refit Kala, banor në fshatin Kalaj, Njësia Administrative Kukur, si dhe dëmshpërblimin financiar të kësaj familje”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2022, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit **Z. Refit Kala**, banor në Fshatin Kalaj, Njësia Administrative Kukur, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. M Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për dëmet ndërtimore si dhe ato në pajisje e orendi të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 të përlllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, për shtetasin **Refit Kala** në vlerën **100 000** (njëqind mijë) lekë.
3. Ti akordoj familjes së shtetasit Refit Kala, ndihmën emergjente në vlerën prej **100 000** (**njëqind mijë**) lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2022.

4. Ndihma financiare për familjen e shtetasin Refit Kala, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
5. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Refit Kala, banesa e të cilëve është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori i Emergjencave Civile), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financar.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Xhulia GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: G. Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes: _____

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Greta LENA

